



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 18.11.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruktion i Mauzoleut të Dëshmorëve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 47,998,000 (dyzet e shtatë milion e nëntëqind nëntëdhjetë e tetë mijë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.363, datë 17/10/2025, me Nr.1291/2 prot., dhe nr. 105, datë 24.01.2025, nr.1291 të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumentet sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.351 datë 14/10/2025 me Nr.12424 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 47,998,000 (dyzet e shtatë milion e nëntëqind nëntëdhjetë e tetë mijë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ditë/ 6 (gjashtë) muaj, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Rikonstruksion i Mauzoleut të Dëshmorëve”. Ky objekt

kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel pa pënguar vijimësinë e punimeve. Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohet që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit. Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së rikonstruksionit të Mauzoleut të Dëshmorëve, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare: (2022, 2023, 2024), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i cili përcakton mundësinë që autoritetet kontraktore të kërkojnë bilancet financiare të tre viteve të fundit për të vlerësuar stabilitetin ekonomik të operatorëve. Gjithashtu, është marrë në konsideratë Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, si dhe Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Kjo kërkesë garanton që operatorët ekonomikë të jenë subjekte me qëndrueshmëri financiare dhe me një historik pozitiv ekonomik, gjë që është thelbësore për një kontratë që përfshin punime ndërtimore, restauruese dhe infrastrukturore në një strukturë publike ekzistuese si “Mauzoleut të Dëshmorëve”. Stabiliteti financiar i operatorit është parakusht për të garantuar që zbatimi i kontratës të mos ndërpritet për mungesë likuiditeti apo probleme financiare. Përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe qëllimin e vlerësimit real të kapaciteteve financiare të operatorit. Ai shërben për të vlerësuar nëse subjekti ka aftësi për të përballuar riskun financiar dhe për të ruajtur stabilitetin e biznesit gjatë periudhës së kontratës. Ky kriter është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve të rikonstruksionit të objektit arsimor.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe me nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, që parashikojnë detyrimin e operatorëve ekonomikë për të dëshmuar përmbushjen e detyrimeve fiskale dhe tatimore përpara lidhjes së kontratës. Gjithashtu, ajo mbështetet në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, pika c, që përcakton detyrimin e subjekteve ekonomike për të paguar taksat vendore në njësinë e qeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike për rikonstruksionin e një objekti arsimor, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Kriteri është formuluar në mënyrë proporcionale, pasi verifikimi i këtij dokumenti kërkohet vetëm për operatorin e renditur të parin, përpara publikimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, duke shmangur ngarkesa të panevojshme për pjesëmarrësit. Në këtë mënyrë ruhet balanca midis parimit të thjeshtësisë së procedurës dhe parimit të transparencës dhe ligjshmërisë. Ky kriter është ligjërisht i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.*

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: Ky kriter është konceptuar dhe përcaktuar në përputhje me Nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili autorizon autoritetet kontraktore të përcaktojnë kriteret për përvojën teknike që lidhen me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës që prokurohet; si dhe me Nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku jepen kufijtë maksimalë të vlefshmërisë së kriterëve që lidhen me përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomikë. Sipas kësaj dispozite, autoriteti kontraktor mund të kërkojë: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës, realizuar gjatë pesë viteve të fundit; ose b) punë të ngjashme me vlerë monetare totale jo më të madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Dispozita e mësipërme nuk vendos një detyrim për të përdorur vlerat maksimale, por përcakton kufij të sipërm, brenda të cilëve autoriteti kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kriteret që vlerëson të nevojshme në raport me objektin e kontratës. Në këtë kuptim, vlerat e përdorura në këtë kriter janë në përputhje me dispozitat ligjore, pasi nuk i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar, por vendosen brenda tyre, në kufirin maksimal të lejuar. Duke qenë se objekti i kësaj kontrate “Rikonstruksion i Mauzoleut të Dëshmorëve” përfshin ndërhyrje ndërtimore, restauruese dhe përmirësuese në një strukturë ekzistuese, si punime në konstruksion, riparime të mureve dhe çatisë, instalime elektrike e hidrosanitare, sisteme të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe punime të finitura, kërkohet që operatori ekonomik të ketë përvojë të dokumentuar në projekte të ngjashme ndërtimore me natyrë publike dhe funksion kulturor apo social. Një ndërhyrje e tillë përfshin punime me standarde të veçanta të cilësisë, pasi objekti duhet të përmbushë kërkesat e siguri së strukturore, higjieno-sanitare dhe funksionale për përdorim nga personeli etj. Për këtë arsye, kërkesa për përvojë të mëparshme në punë të ngjashme, në vlera të përafërta me fondin limit të kësaj kontrate, është një mekanizëm i arsyeshëm dhe proporcional që siguron se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike, profesionale dhe organizative të nevojshme për të realizuar me sukses projektin. Një operator që ka përvojë në punë të këtij niveli ka dëshmuar jo vetëm aftësi teknike dhe menaxheriale për të përballuar kontrata të ngjashme në përmasë dhe kompleksitet, por edhe kapacitet për të respektuar standardet e cilësisë dhe afatet kontraktore, të cilat janë thelbësore në projektet e rikonstruksioneve arsimore.

Në këtë drejtim, përcaktimi që një operator mund të kualifikohet nëse plotëson njërin prej dy kushteve — pra, ose ka realizuar një kontratë me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit, ose ka realizuar kontrata të ngjashme me vlerë totale jo më të vogël se dyfishi i fondit limit — është konceptuar për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe të hapur ndërmjet operatorëve ekonomikë. Ky parashikim nuk krijon barriera të panevojshme hyrjeje në procedurë, por garanton që pjesëmarrësit të kenë përvojë reale në fushën përkatëse dhe aftësi të provuara për të zbatuar me sukses një kontratë të kësaj natyre.

Prandaj, ky kriter është ligjërish i bazuar, proporcional me objektin dhe qëllimin e procedurës, dhe në përputhje të plotë me parimet themelore të Ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021, që kërkojnë siguri për zbatimin cilësor të kontratës, konkurrencë të ndershme dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Ai siguron që operatorët që kualifikohen të kenë përvojë në përballimin e kontratave të ngjashme në përmasa dhe natyrë, të kenë aftësi organizative dhe teknike për të realizuar kontratën në cilësinë, afatin dhe buxhetin e kërkuar, si dhe të garantojnë një zbatim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të punimeve të rikonstruksionit të “Mauzoleut të Dëshmorëve”, në përputhje me standardet e ndërtimit publik dhe me interesin publik që mbart ky objekt kulturor për komunitetin.

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme te ndërtimit:

- NP – 1A Punime gjurmimi ne toke;
- NP – 3A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Per punimet speciale te ndërtimit:

- NS – 1A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS – 2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- NS – 4A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami;
- NS – 14A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj;
- NS – 18A Punime topogjeodezike

Sipas modelit te lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit ne fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr.92, datë 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licencat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Pikat e licensave janë përcaktuar në bazë të zerave të përshkruara në preventivin e projektit. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në leke të punimeve të kryera për çdo kategori punimi:

Kategoria e kerkua	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese	Niveli i klasifikimi i kerkuar per kategorine respektive	Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese
NP-1	Punime gërmimi ne toke.	2.25 Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me goma $0.25m^3$, shkarkimi ne toke m^3 2.1a Germim dheu me krah e transport k dore $10m$, kat IV m^3 3.47/1a Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo $30 cm$, toke te bute 3.44/1 Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri $0.75 m^2$	A 224,097.83 Lek	$0 \div 20$ milion
NS- 1	Punime per prishjen e ndertimeve .	2.426/9 Prishje suvatim i jashtem 2.426/1 Prishje mur tulle me pastrim 2.426/11 Prishje suvatim muri i brendshem 2.426/12 Prishje suvatim solete ($h < 4m$)	A 3,974,796.54 Lek	

		2.426/14 Prishje shtrese h/izolim tarace 2.430 Prishje shtrese lluster-çimento dysHEMEJE 2.430/3 Prishja e rrjetit ekzistues elektrike 2.430/4 Prishja e rrjetit ekzistues hidraulik 2.426/3 Prishje shtresa betoni 2.405/1 Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh 2.426/10 Prishje trotuari ekzistues 2.281 Heqje pllaka dysHEMEJE 2.281/1 Heqje bazamake shkallësh 2.208/2 Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato 2.608 Heqje dyersh me kangjella metalike 2.581 Heqje parmakes metalike, shkallësh e ballkonësh 2.370/1 Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese 2.568 Heqje konstruksione metalike 2.615 Heqje pajisje hidrosanitare 2.109 Heqje muri me kartonxhes		
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	2.264 Shtrese lluster cimento 1:2 m2 755 2.262/1 Shtrese betoni C 7/10 m3 2.258 Nenshtrese zhavori m3 2.262/4 Shtrese betoni C 16/20 m3 2.166/1a F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm 2.166 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm 2.182 F.V. Konstruksione metalike te thjeshta. 2.40 Transport mbeturinash, nga prishje te brendshme te godines, me krahe	A 7,774,962.18 Lek	0 ÷ 20 milion

		2.25 Germim dheu themele e plinta me $b > 2m$, ekskavator me goma 0.25m³, shkarkimi ne toke 2.1a Germim dheu me krah e transport k dore 10m, kat IV 4.3 Konstruksione metalike te thjeshta 3.47/1a Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te bute 3.44/1 Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri 0.75 m² 3.244/1 Struktura te holla monolite betoni C 20/25 2,109 Themel e xokol betoni C 12/15 2,118 Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 8m 2.204 Brez b/a C20/25		
NS – 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	3.164/1t F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm 2.342 Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize 2.337 Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 150 cm AnAn F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm Anan F V pompe me pulmon 24 litra Anoferte Kondicioner kollonë, 48000 BTU, Inverter Anoferte Kondicioner, 24000 BTU, Inverter, An Fikese zjarri me CO2 5 kg	A 2,379,467.43 Lek	0 ÷ 20 milion
NS – 4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.	2.273/1a Shtrese me pllaka graniti t=3cm 2.276 Shtrese parketi 2.609 F.V. Davancial granili derdhur ne vend 2.373/1 F.V. Vetrare d/alumini plastike me dopio xham	A 19,919,580.98 Lek	0 ÷ 20 milion

		2.375/2a Dritare d/alumini dyfi xh. 2.383/1 F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. 2.395/a Dyer d/alumini me mbushje element d/a. 2.386/2 Dyer te blinduara 1.117/p1 Bazamak shkalle me granil 1.120/p Parapet shkalle dhe ballkoni me granil 1.182/p Dyer metalike 2.324b Plintuse grez h = 10 cm 2.358/c Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva. 2.326 Veshje me pllake majolike 2.303 Suva solete > 4 m, me drejtues, me krah 2.310 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 2.352/a Suva fasade me granil e çimento te zak, h > 8m. 2.331 Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m 2.297/a Veshje tavani me kartonxhes 2.328/1 Patinim muri me stuko 2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte 2.404/1 Boje hidroplastike cilesi e larte 2.408 Pllake b/a granili mbi mure rrethues 3.639 Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm 3.643 Mbjellje bari ne skarpat An Rrjete plastike per suvatim An Shtrim me pllaka gur trani AnAn F.V kapak guri trani per kuneten 2.196/b Hidroizolim me nje shtres astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B 2.239/a Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm 2.197 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama		
--	--	--	--	--

		2.209 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 2.206 Kasete shkarkimi me llamarine xingat		
NS – 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	2.490/d F.V. Kasete plastike KE me 12 modular (vende) 2.490/f F.V. Kasete plastike KE me 36 modular (vende) 2.547 F.V. Panel i matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste 2.537 F.V. Automat termo-elektro magnetik, 4P; 380V; 40A 2.490/1 F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A 2.490/1c F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A 2.490/1b F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A 2.561 F.V. Llampe sinjalizimi 220V; 1.2ë 2.481/1 F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 2.481/2 F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 2.481/3 F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2 2.481/5 F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm2 2.481/4 F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm2 2.500 F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur 2.480/5 F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm 2.480/1 F.V. Tub plastmasi Ø 14-17mm 2.480/3 F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm 2.483 F.V. Çelesa e priza 10 A 2.487/a F.V. Kuti suport pllaket 2 mod 2.485/d F.V. Priza shuko universal 2.485/b F.V. Priza bivalente 220V 10A 2P-T 2.483 F.V. Çelesa e priza 10 A 2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	A 3,531,762.90 Lek	0 ÷ 20 milion

		2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m 4.131/3.7 F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm² 3.176 F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 3.172 F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement Anan F.V. kuti shperndarese PT7,PT8, PT11 Anan Ndricues Katror LED 50ë , 4000-6000K,3200lm, 600*600mm Anan Ndricues katror LED me 18ë , 4000K,1800lm, Anan Kabell interneti cad 6 Anan 16 Port Rackmount Sëitch profesional Anan FV Fiber Optike, 8 core, Multi Mode per instalim te brendshem Anan Shirit tok hekuri zingato 30x3 mm , + zbritje Anan Maja rrufepritesezingato Dn-16mm,L0,5m Anan Fiksues te konturit ne parapet Anan Fiksues te shkarkueses ne fasade An "F.V Shtylle dekorative metallike ndricimi, h=5 m, Ø102, me strukture e zinguar me te nxehte ne vaske zingu dhe e lyer me boje elektrostатike me pjekje ne temp 250°. Me Ndricues LED OSRAM 60-80 Ë, shperndarja e ndricmit me lente asimetrike. Ngjyra e drites natyrale: 4000K I kompletuar me automorset, sigures, kapak dhe kabllim deri te dritarja e shtylles" Anan Demontim:Heqje shtylle ndricimi +transport Anan F.V. Puseta elektrike 30*30 Anan F.V.Kabell cu FROR 3 x 4mm² Anan F.V.Kabell cu FROR 3x 2.5mm² .		
--	--	---	--	--

		Anan F.V.Kabell cu FROR 3x 2.5mm2 . Anan F.V Tub HDPE SN8 d=250mm		
NS – 18	Punime topogjeodezike	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rilevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.	A	0 ÷ 20 milion

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Lidhur me këtë kriter, çdo ofertues duhet të disponojë, si dhe duhet të paraqesë në tender, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht: Kontratën e punës të vlefshme, diplomën përkatëse. (Drejtuesi Teknik të jetë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa e mësipërme është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinier në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtim, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin

në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinier e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierin e kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

- Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit ,stabiliznatit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll,stabilizant binder dhe asfalt.

Shënim: Bazuar ne Rekomandimin Nr.6732, date 21.10.2020 ”Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”, inxhinieri i mësipërm duhet te vetdeklarojë se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|---------|
| a. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| b. Inxhinier Gjedoet | 1 (një) |

- | | |
|---|---------|
| c. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| d. Teknik ndërtimi | 1 (një) |
| e. Punonjës i pajisur me Master Profesional | 1 (një) |
| Restaurim Monumentesh Kulturore/ ose | |
| Me licencë në fushën e rastaurimeve nga | |
| Institucionet publike përkatëse | |

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Diploma*
- *CV*
- *Kontrata e punës*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------------|------------------|
| a. Drejtues Mjeti | 1 (një) |
| b. Manovrator | 1 (një) |
| c. Elektracist | 2 (dy) |
| d. Hidraulik | 2 (dy) |
| e. Pllakashtrues | 5 (pesë) |
| f. Hidroizolues | 4 (katër) |
| g. Murator | 2 (dy) |
| h. Specialist suvatimesh | 4 (katër) |
| i. Bojaxhi | 4 (katër) |
| j. specialist për punime në lartësi | 4 (katër) |
| k. karpentier | 4 (katër) |
| l. hekurkthyes | 4 (katër) |
| m. Punëtorë ndërtimi të thjeshtë | 12 (dymbëdhjetë) |

Për këta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- *kontratën individuale të punës;*
- *një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.*

- *certifikate te sigurimit teknik e lëshuar nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtarë akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Për punonjësit drejtues, ofertuesi duhet të paraqesë:

- *Kontratën individuale të punës te vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).*

Për punonjësit Manovratorë duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet ne Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

- *Për punëtorët e thjeshtë, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme .*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në*

Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, ne mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne katër elementet e strukturës së kostos(material, punëtori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit ,stabiliznatit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll,stabilizant binder dhe asfalt.
- **Inxhinieri gjeodet** është kërkuar me qëllim realizimin e rlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Inxhinieri i Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit elektrik për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin punimeve elektrike.
- **Tekniku i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore ne baze të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Punonjës i pajisur me Master Profesional Restaurim Monumentesh Kulturore** është i nevojshëm për punimet që do të kryhen për ruajtjen e mozaikut dhe pjesën e fasadës së muzeut.
- **Drejtuesit** e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere
- **Manmuvratori** shërben për drejtimin e fadromës.
- **Elektricitistët** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike.
- **Hidraulikët** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve hidraulike.
- **Muratorët** janë të nevojshëm për muret e reja
- **Pllakashtruesit** janë të nevojshëm për punimet e shtrimit të pllakave
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për realizimin e zërave të hidroizolimeve të ndryshme sipas projektit, shtresat përkatëse sipas projektit.
- **Specialist suvatimesh** janë të nevojshëm për suvatimin e mureve të brendshme , punimin e kartonxhesit .
- **Specialist e punimeve në lartësi** janë të nevojshëm për punimet e fasadave me skeleri.
- **Bojaxhiu** janë të nevojshëm për lyerjet.
- **Hekurkthyesit dhe karpentierët** janë të nevojshëm për punimet e hekurit (strukturat betonarme)
- **Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit** janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin të objekti.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 53 persona, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve prej 53 punonjës, përfshin punëtorë të thjeshtë + persona janë stafi i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë, person specializuar/të kualifikuar dhe person manovratorë/shoferë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve të punës dhe grafikut të punimeve. Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerve/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

Numri i punonjësve dhe qendrueshmeria e tyre në punë me koheshtrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmeri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik është nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këte koheshtrirje është dokument vërtetues për qendrueshmerinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punesimi i një numri të caktuar, përveç besueshmerisë së operatoreve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA	Statusi
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton	1 copë	Ne pronësi ose me qira
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton	1 copë	Ne pronësi ose me qira
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton	1 copë	Ne pronësi ose me qira
Autobetoniere	1 copë	Ne pronësi ose me qira
Minifadromë	1 copë	Ne pronësi ose me qira
skela	500 m2	Ne pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente

mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.” Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kërkohet që operatorët ekonomike t’i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njësi është bazuar tek zërat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkrijnë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Automjetet vetëshkarkuese janë kërkuar për transportin e dherave apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve. Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten automjetet vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Ky numër është i nevojshëm në raport edhe me vëllimin e materialeve.

Automjetet vetëshkarkuese janë të nevojshëm për ngarkimin e shkarkimin e materjaleve të ndryshme që duhen për zbatimin e objektit.

Autobetoniere është e nevojshme për punimet e betonit

Minifadromë është e nevojshme për punimet e jashtme.

Skelat janë kërkuar për punimet e fasadës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- a. Certifikata: ISO 9001 – “Sistemi i Menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme ose ekuivalente.
- b. Certifikata: ISO 14001– “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” e vlefshme ose ekuivalente.
- c. Certifikata: ISO 45001 – “Sistemi i manaxhimit shëndetit dhe sigurisë në vendet e punës”, e vlefshme ose ekuivalente.

Certifikatat si me sipër duhet te paraqiten origjinale ose kopje te noterizuara, te lëshuara nga një organ i vlerësimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, te nenit te 77, si dhe nenit nr. 79 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-se Nr.285, date 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçante, vendndodhjes dhe përmasat e objektit te kontratës qe do te prokurohet, është tepër e rëndësishme qe operatoret si zbatues, te kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara te cilësisë. Sistemi i menaxhimit te cilësie, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë ne pune janë standarde qe çdo subjekt juridik apo privat e ka qellim ne arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës presa kohe do te pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve te operatoreve ekonomike dhe te mundësisë se tyre për përmbushjen e plote te kontratës. Referuar ne nenin 79 te ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund te kërkojë certifikata, te lëshuara nga organe te pavarura, qe vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose te ofertuesit me standardet e kërkuara te cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë ne pune. Duke qene se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon te drejtën për t’u garantuar se operatoret ekonomike pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët qe do te kryhen, e rrjedhimisht është e drejte e këtij te fundit t’u kërkojë ofertuesve te paraqesin certifikata te lëshuara nga organe te pavarura te njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

-Për ISO 9001: Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një sistem te menaxhimit te cilësisë, ku një operator ekonomik duhet te tregojë aftësinë e tij qe vazhdimisht te siguroje pune/mallra ose shërbime qe plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatorë, si dhe synon te rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv te sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim te vazhdueshëm te sistemit dhe sigurimin e konformitetit te klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatorë.

-Për ISO 14001: Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një sistem te Manaxhimit mjedisor përfaqëson kalimin e drejtimit te kompanisë nga vetëm respektimin e ligjeve, ne një manaxhim te aktivitetit përkushtuar parandalimit te ndotjes dhe te përmirësimit te ndikimeve mjedisore. Mbrojtja e mjedisit merr për çdo kompani një rol gjithmonë e me te rëndësishëm. Shumëllojshmëria dhe shtimi i burimeve te ndotjes, kontrolli gjithmonë e me i kujdesshëm qe

shtetet janë duke bere rreth temës se mjedisit dhe ashpërsimi i dënimeve për cilindo qe ndot mjedisin, tregojnë qe është e nevojshme qe te veprohet.

-Për ISO 45001: Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një instrument organizativ qe lejon menaxhimin ne mënyrë organike dhe sistematike te sigurisë ne pune, duke theksuar kërkesat e mëposhtme:

Adoptimi i një politike për menaxhimin e sigurisë;

Identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i tyre, identifikimi i metodave te kontrollit, te lidhura ngushtë me rregullat ligjore ose masat e tjera;

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të hartuar për objektin “Rikonstruksion i Mauzoleut të Dëshmorëve” janë përgatitur në përputhje me standardet kombëtare të ndërtimit dhe me kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe aktet nënligjore përkatëse. Qëllimi i tyre është të sigurojnë zbatimin me cilësi, siguri dhe efikasitet të ndërhyrjeve ndërtimore dhe restauruese në një objekt arsimor me funksion publik. Duke qenë se ndërhyrja konsiston në rikonstruksion të plotë të godinës ekzistuese, përfshirë prishje të pjesshme, ndërhyrje strukturore, rikonstruksion të çatisë, mureve, dyshemeve, instalimeve elektrike e hidrosanitare dhe përmirësim të kushteve funksionale dhe estetike të ambientit, specifikimet janë të domosdoshme për të udhëzuar zbatuesin në mënyrë të qartë dhe të kontrollueshme. Nëpërmjet këtyre specifikimeve përcaktohen parametrat teknikë të materialeve që do të përdoren, si dhe standardet e sigurisë gjatë kryerjes së punimeve. Zbatimi i këtyre specifikimeve është thelbësor për të garantuar që objekti, pas ndërhyrjes, të përmbushë kërkesat e sigurisë strukturore dhe funksionale në përputhje me normat bashkëkohore të ndërtimit për institucionet kulturore. Përmes tyre sigurohet që rikonstruksioni të realizohet me standarde të larta teknike, të qëndrueshme në kohë, me efikasitet energjetik dhe kushte më të mira. Në këtë kuptim, specifikimet teknike janë konceptuar si instrument zbatimi i domosdoshëm për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e ndërhyrjeve, duke reflektuar natyrën dhe qëllimin publik të investimit. Ato janë në përputhje të plotë me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe zbatimit korrekt të fondeve publike, duke siguruar që projekti i rikonstruksionit të “Mauzoleut të Dëshmorëve” të kontribuojë realisht në përmirësimin e infrastrukturës. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore

kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Shënim: Në çdo kërkesë të preventivit ku është shënuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit